



25
vjet

Çerek shekulli bashkë!



albaqeramika
.....
Amfora

Këtë vit, Albaqeramika feston një përvjetor të jashtëzakonshëm. Në 25-vjetorin e hapjes së sallonit tonë të parë, ne kthejmë kokën prapa me krenari për të parë arritjet tona, dhe besojmë se kemi arsyë të forta pse jemi optimistë për të ardhmen.

Në vitin 1993, ne hapëm salloni tonë të parë në Pejë, ndërsa sot kemi sallonet tona edhe në Prishtinë dhe Prizren. Shumëçka ka ndryshuar që nga ajo kohë, por përkushtimi për të ofruar produkte cilësore, inovative dhe për të qenë sa më afër klientëve tonë, vetëm se është rritur.

Këto vlera besojmë e kanë vëçuar kompaninë tonë nga të tjerat në tregun kosovar. Këto vlera kanë qenë udhërrëfyes të famijes Deçani, menaxhmentit të kompanisë dhe të gjithë stafit në përgjithësi.

Në këtë jubilar të rëndësishëm, ne falënderojmë të gjithë miqtë dhe partnerët tonë, si dhe stafin e përkushtuar të kompanisë.

Falendërim të veçantë shprehim ndaj klientëve tonë, të cilët vazhdojnë t'u qëndrojnë besnikë kompanisë!

Sikur në ditët e para të punës, ne kemi ambicie të rritemi. Së bashku me ju!

Edhe shumë çerekë të tjerë, bashkë!



Albaqeramika funksionon si një familje e madhe

Pa dyshim që familja është baza e çdo fillimi të suksesshëm. Për Albaqeramikën ka qenë gjithmonë e rëndësishme pérkrahja e nënës, znj. Mjesere Deçani. Këshillat dhe angazhimi i saj i vazhdueshëm kanë qenë kyçë për zhvillimin e suksesshëm të kompanisë. Në fakt, Albaqeramika funksionon si një familje e madhe.

Gëzuar 25 vjetori të gjithëve!

Sejfullah Deçani

Sonte jemi mbledhë këtu që të festojmë. Por nganjëherë fjalimet janë të pashmangshme. Më duhet t'i them dy-tri fjalë. Mua më së paku më mbetet të flas mbasi të tjerët kanë çka të flasin, ndoshta edhe më tepër. Unë, më dëshirë kisha me ju përvendetë të gjithëve, së pari anëtarët e familjes së Albaqeramikës. Flux-it, Glam Radios, marketingut, mirëmbërëma dhe mirë se keni ardhë. I përvendetës edhe mysafrët e nderuar nga Shajpëria, partnerët tanë. Gjithashtu edhe ata nga Kosova. Një përvendetje të veçantë e kam për një mik tonin, përfaqësues të një industrie, e cila është një ndër pesë prodhuesit më të mëdhenj të plakave të qeramikës në Itali, z. Simone.

Mirëserdhe z. Simonel. Me një kënaqësi shumë të madhe po ashtu posaçërisht i përvendetës shoqërinë time, me të cilët i kaloj ditët më të këndshme të jetës. Sigurisht nuk është e rastit që ky jubile përpunhet edhe me ditëlindjen time. Po më merr nipi në telefon dhe po me thotë "Babush urime 57-vjetorini!". I thashë "Faleminderit babush, po ndoshta janë 75 e jo 57", dhe krijuam pak polemikë derisa Valdeti nuk na ndërpren. Së na janë përzier shifrat, sigurisht. Tha: "Babë, leni ato fjalë, urime 25-vjetorin!". Kjo do të thotë që këtë vit të gjithë ne i kemi mbush 25 vjet. Jemi në moshën më të mirë të pjekurisë. Pra, gëzuar 25-vjetori të gjithëve dhe ishalla së bashku festojmë edhe përvjetorë tjerë dhe ditëlindje tjera.

Kemi me siguri çka me i thënë njëri-tjetrit, kemi kujtime për këto 25 vjet, edhe të këndshme edhe më pak të këndshme. Megjithatë, kompania e ka pasë një dinamikë, shumë të madhe të zhvillimit, për atë ne jemi falenderues të kontributit të secilit prej nesh dhe ne, unë së pari dhe familja ime, jemi shumë mirënjohës. Jemi ndjerë komod dhe kemi qenë të lumtur deri më tanë mes jush së bashku. Pra, gëzuar 25-vjetori dhe të gjithë ndjehuni sonte në disponim të këndshëm dhe argëtohuni. Nësër na pret puna prej fillimit! Gëzuar!

Fjalimi i Sejfullah Deçani është mbajtur në festimin e 25-vjetorit të Albaqeramika.



Jeta është dhe bëhet e bukur kur ti ke në krah njeriun e duhur!



Mijesere Deçani

Dua që të ndaj me ju edhe një befasi për shokun tim të jetës. Si sot 50 vjet më parë, i thamë njëri-tjetrit "Po" dhe sigurisht që vitet treguan që jeta është dhe bëhet e bukur kur ti ke në krah njeriun e duhur.

Paçim jetë e gëzofshim si këto ditë. 50 vjet është një jete dhe që të flasësh duhet t'i jetosh. 50 vjet kaluan dhe më duket se jemi në muajin e parë të lidhjes sonë.

Urimel

Së bashku do të festojmë edhe shumë përvjetorë të mirë

Shumica prej jush e dinë që unë nuk kam shumë dëshirë të flas para publikut, por në këtë rast të veçantë e bëra zemrën guri dhe dola para jush. Zakonisht unë jam më shumë i fokusuar në punë e për të folur i kam disa bashkëpunëtorë/shokë të cilët e fitojnë bukën e gojës duke folur. Kur jemi te puna do të kisha pasë dëshirë ta cekë se e gjithë kjo që kemi arrit deri sot është rezultat i punës së pa lodhshme. Puna dhe rëndësia e saj ishte ai virtut që ma mbolli baba si i ri.

Por jo vetëm puna si veprim. Puna, siç thotë edhe sot baba im, duhet të bëhet me nder, me sinqueritet dhe duke respektuar gjithmonë ata me të cilët punon.

Këto vlera i ruajmë me xhelozit dhe në asnjë moment nuk bëjmë kompromis me to. Albaqeramika me kalimin e yjetëve fillai të rritet dhe është një kënaqësi e veçantë që çdo njëri që i bashkohej kompanisë tonë i përqafonte këto vlera dhe i ruante ato me po të njëjtën xhelozit si edhe ne. Kjo ishte një garancë se do të rritheshim edhe më shumë. Dhe sot kur e festojmë një ditë të veçantë në historikun e kompanisë sonë, të gjithë duhet të jemi krenarë, sepse gjithsecili nga ju e ka vënë nga një gur në mozaikun e asaj që kremitojmë sot. Sonte kemi në mesin tonë anëtarë të familjes tonë të madhe edhe nga kompani simotra, siç janë Flux, Glam Radio, Mozaik dhe Vepër. Ky është tregues se nëse i mbajmë gjallë vlerat mbi të cilat është ndërtuar Albaqeramika, do të kemi edhe shumë suksese.


Vlerat tona respektohen edhe të partnerët tanë ndërkombëtarë dhe ata i kemi edhe sonte këtu, sepse edhe ata janë pjesë e familjes sonë. Si shembulli më i mirë i kësaj që thash, është prania e Simonit i cili me të vërtetë është pjesë e pandashme e familjes së Albaqeramikes, ku ai shpesh e quan veten AlbaMan. Jam gjithash tu i nderuar që në mesin tonë gjindën edhe Ermiri dhe Shkelzeni, si miq të Albaqeramikës, në rend të parë, dhe si përfaqësues te Ragni-Marazzi dhe Kludi, në rend të dytë. Si përfundim, mund të them që 25 vjet nuk janë edhe shumë për një kompani. Por kur e di që çdo ditë në këto 25 vjet e kam shijuar në plotni, atëherë kjo ditë bëhet e veçantë.

Këtë e kemi bërë bashkë dhe dua të ju falënderoj se cilin prej jush nga zemra që ma bëni çdo ditë të jetë speciale.

Urime 25-vjetorin. Së bashku do të festojmë edhe shumë përvjetorë të mirë.



Fisnik Deçani



Hare Deçani

"Krenohemi me ju, babush!"

Sot, përvèç që e festojmë 25-vjetorin e Albaqeramikës, e festojmë edhe ditëlindjen e 75-të të personit më të veçantë, më të urtë e më të dashur. Ditëlindjen e gjyshit, që me vlerat, mirësinë, zemërgjerësinë dhe me mënyrën se si tregon respekt për të gjithë njerëzit - na inspiron. Etika e tij e punës do të jetë motoja e jetës simel Këshillat e çmuara, që i akumuloi gjatë rrugëtimit jetësor, janë si një bibliotekë për mendjen tonë. Mënyra se si ai e vlerëson në çdo aspekt artin, muzikën, filozofinë e jetës, tregon për madhështinë e tij. Krenohemi me ju, babush! Do të dëshiroja që në emër të gjithë familjes të urojmë ditëlindjen dhe një jetë të gjatë e të lumtur, të fortë e të bashkuar me Albaqeramika.

Fjalimi i Hare Deçanit është mbajtur në festimin e 25-vjetorit të Albaqeramika.

Albaqeramika është krenare me punonjësit e saj

Albaqeramika ka arsyë për të qenë krenare për shumëçka. Por, ne konsiderojmë se pjesa më e çmuar e jona është stafi ynë. Përkushtimi i tyre për profesionalizëm ka luajtur rol kyç në zhvillimin e Albaqeramikës.

Sot, ne shprehim mirënjojje të thellë për kontributin e çmuar të tyre.





Izet Dibrani,
Prishtinë

Albaqeramika, kompani e guximshme

I uroj së pari Sejfullah Deçanit ditëlindjen. Uroj të vazhdoni të keni shëndet dhe të prisni edhe shumë vite tjera të lumtural. E uroj familjen Deçani dhe gjithë kolegët e mi për 25-vjetorin e Albaqeramikës.

Meqenëse jemi vend i ri dhe ekonomi e re, me i pasë 25 vjet aktivitet domethënë që ke qenë në treg që prej fillimit të ekonomisë në këtë rajon. Për Albaqeramikën, një kompani me traditë në Kosovë, është e vendosur në rang me kompanitë që kishin guximin ta fillonin aktivitetin qysh herët në një vend të ri. Kjo është krenari për themeluesit, e padyshim është krenari edhe për gjithë neve, që punojmë e që kontribuuam për zhvillimin e vazhdueshëm të Albaqeramikës.


Është një ndër dhe prestigj të punoj në një kompani që ka një çerek shekulli që operon. Të qëndrosh në treg për një kohë kaq të gjatë flet për një organizim, planifikim dhe vizion të qartë, që shpalosen hap pas hapi, ditë pas dite e vit pas viti. Duke qenë të gjithë së bashku në këtë projekt që sot feston 25-vjetorin dhe duke njohur njërit-tjetrin dhe kontributin e dhënë, ne jemi shumë optimistë edhe për të ardhmen. Pra, edhe 25 vjet tjera të suksesshme janë të sigura. Por edhe shumë çerekë shekuj të tjerë do të festojmë për Albaqeramikën. Sepse në dimë ku do të arrijmë, si do të arrijmë dhe të gjithë jemi të vendosur për këtë. Zoti ju bekofte të gjithëve, zoti e bekofte Albaqeramikën.

Fjalë rasti në ahengun e organizuar për 25-vjetorin e Albaqeramikës

Albaqeramika do të ecë çdo ditë, mirë e më mirë

Së pari desha të ia uroj z. Sejfullah ditëlindjen. Shpresoj që të numërojë edhe shumë vite të tjera të suksesshme dhe të shëndetshme. Uroj familjen Deçani dhe mbarë familjen Albaqeramika për 25-vjetorin e firmës.

Unë në Albaqeramika erdha para 10 vjetësh dhe që nga dita e parë deri më sot, kalova një rrugëtim të mrekullueshëm. Pata përkrahjen morale atëherë kur unë kisha nevojë. Jam shumë krenare që sot po e festojmë 25-vjetorin dhe e di që secili prej nesh bashkë me menaxhmentin jemi të përkushtuar në punë dhe punojmë në një firmë lidere në Kosovë. Për këtë mburremi shumë. Uroj shumë që në përvjetorët tjera të ketë sukses të mëtejshme, gjë të cilën e di shumë mirë që Albaqeramika do të ecë çdo ditë, mirë e më mirë.



Albana Basha, Pejë

Fjalë rasti në ahengun e organizuar për 25 vjetorine Albaqeramikës

Kompani me profesionalizëm të lartë

Mirëmbërëma të gjithëve. Ju përshëndes dhe faleminderit ProCon-it për këtë organizim shumë të bukur të 25-vjetorit jubilar. Së pari dëshiroj ta përshëndes z. Sejfullah Deçani ose si e thërrasim ne familja jonë axhën Sefë tonë të dashur. I uroj ditëlindjen, i uroj shumë shëndet dhe suksese të mëtutjeshme. Dhashtë zoti të festojmë së bashku edhe më shumë, kësó festa që i kemi të përvitishme. Përshëndes pronarët, shefat tanë, z. Fisnik Deçani, z. Valdet Deçani, znj. Mijesere, i përshëndes të gjithë kolegët, që veç po shtohen pér çdo vit. Siç e dinë shumica e kolegëve, unë jam pjesë e Albaqeramika që pesë vjet, që nga fillimi i ndërtimit të objektit në Prizren. Dhe pér këto pesë vjet kam përcjellur zhvillimin e kësaj kompanie, e cila është bë një gjigant i vërtetë, profesionalizmi që shtohet më shumë e më shumë. Ndër vite, Albaqeramika ka mbërrë profesionalizëm shumë të lartë. Jam shumë falënderues pér këtë, sikurse që jam falënderues pér nderin e dhënë që të flas para gjithëve juve këtu. Pra, urime këtë 25 vjetor, dhe dhashtë zoti të festojmë edhe shumë përvjetorë të tjera. Faleminderit!

Fjalë rasti në ahengun e organizuar pér 25-vjetorin e Albaqeramikës

Ilir Baxhaku, Prizren



Albaqeramika sjell trendet ndërkombëtare në shtëpitë tuaja

Në 25 vjetët e operimit të saj, Albaqeramika ka qenë gjithnjë në hap me trendet ndërkombëtare. Ne jemi siguruar që pér ambientet e shtëpive tuaja të sjellim para se gjithash cilësi, por në sallonet tona asnjeherë nuk ka munguar inovacioni dhe dizajnet e përkryera. Ne jemi të vëtëdijshëm se një gjë e tillë do të ishte e pamundur pa bashkëpunimin me kompanitë ndërkombëtare, andaj përgjatë këtyre viteve, kemi sjellur në Kosovë prodhuesit më të njojur në botë. Kështu, sallonet tona kanë qenë çdo herë përplot me pllaka moderne, sanitari cilësore, sisteme të qëndrueshme dhe dizajne të përshtatura pér çdo ambient, të sjellura në vendin tonë nga partnerët e besueshëm ndërkombëtarë të Albaqeramikës. Ndër bashkëpunimet e para dhe ndoshta më i rëndësishmi, ka qenë me korporatën e njojur Ceramica d'Imola, me kompanitë e saj Imola Porcelanite, Lafaenza dhe Leonardo. Përmes kësaj korporate, në Kosovë ne kemi sjellur pllakat më cilësore dhe me dizajne të jashtëzakonshme.

Po ashtu, Albaqeramika është e lumtur që gëzon bashkëpunim të qëndrueshëm edhe me kompani të tjera, siç janë Geotiles, Kolpasan, Remer Rubinetteria, etj të cilat kanë shtuar llojshmërinë pér konsumatorin e Kosovës. Bashkëpunimi në mes Albaqeramikës dhe kompanive me nam ndërkombëtar është mundësuar nga profesionalizimi dhe besimi i ndërsjellë. Ne jemi të lumtur që në festën tonë pér të shënuar ditëlindjen e 25-të të Albaqeramikës, morën pjesë përfaqësues të Cooperativa d'Imola, Ragno dhe Kludi të cilët uruan Albaqeramikën pér arritjet e saj.





Për ditëlindje, Albageramika shpërbolen klientët me dhurata!

Albageramika ka organizuar lojëra shpërblyese në rrjetet sociale për të festuar bashkë me qytetarët 25-vjetorin e themelimit të kompanisë.

Artan Ahmeti ka fituar në lojën shpërblyese "Aventura Via Ferrata". Së bashku me miqtë e tij, Artani ka shjuar bukuritë e bjeshkëve të Rugovës, duke bërë ngjilje përmes "Via Ferrata" dhe duke e provuar adrenalinën që e ofron "Zip Line".

Kurse, fituesi tjetër, Shkopet, ka shjuar bukuritë e Ksamilit në Shqipëri, pasi që fitoi në lojën shpërblyese "Vikend në Ksamil". Fituesit e këtyre lojëratave janë zgjedhur në mënyrë kompjuterike.



www.facebook.com/albaqeramika



twitter.com/ALBAQeramika



www.instagram.com/albaqeramika



+377 45 60 29 99 Prishtinë
+386 49 20 50 50 Pejë
+386 49 21 80 80 Prizren

Në Alba Qeramika mund të paguani edhe me POS të këtyre bankave :



ALBA Qeramika, km IV, magjistralja Prishtinë - Ferizaj

10000 Prishtinë

+386 49 20 60 60

office@albaqeramika.com

Implementuar nga



professional consulting